



**J.V**  
"47EK79 & ILIRIADA P.K.S." sh.p.k  
&  
"GJEOKONSULT & CO" sh.p.k.



## RELACION TEKNIK



Bazuar ne Vendimin e Keshillit Teknik Nr.17, date 05.05.2020 te Autoritetit Rrugor Shqiptar

Objekti: "Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 4"

### Të përgjithshme :

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR dhe JV "COBIAL"sh.p.k & "GJOKA KONSTRUKSION"sh.a, kanë lidhur kontratë për Objektin: "Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4" me Nr 6706/6, datë 24.09.2018 me afat 24 muaj dhe vlerë kontrate **2.831.547.930,71 Lek** (me T.V.SH).

Projektues: "47 EK 79 & ILIRIADA P.K.S"shpk & "GJEOKONSULT & CO"shpk

Mbikqyrës Punimesh: "47 EK 79&ILIRIADA P.K.S"shpk & "GJEOKONSULT&CO"shpk

Data e fillimit të punimeve: **25.09.2018**

Data e përfundimit të punimeve: **24.09.2020**

Vlera e rishikuar e Kontratës në bazë të Vendimit të Këshillit Teknik të ARRSh-së Nr.25, datë 25.06.2019: **2.831.547.240,28 Lek** (me T.V.SH).

### Pershkrim i projektit :

Projekti për ndërtimin e rrugës Kardhiq – Delvinë, Loti 4 (0+000.00÷6+150.00) fillon në piken fundore te **Lotit 1** (Përfunduar Ndërtimi) në afërsi të kryqëzimit me fshatin Fushebardhe, **Km 0+000** dhe perfundon ne afersi te Qafes se Skerfices ne **Km 6+150**.

Gjatësia totale e Lotit 4 është **6150m** dhe terreni që përshkon ky lot është kondrinor dhe malor.

Rrezet minimale variojne nga R=80m deri R=120m.

Pjerresia maksimale deri ne 9%

Shpejtesia e projektimit 80 km/ore





**J.V**  
**“47EK79 & ILIRIADA P.K.S.” sh.p.k**  
&  
**“GJEOKONSULT & CO“ sh.p.k.**



Në përgjithësi seksioni tërthor i rrugës është në gjermim.

Parametrat e rrugës për seksionin tërthor tip janë :

- 2 korsi me gjerësi nga 3.5m të asfaltuara
- 2x0.25m shirita të vijëzuar
- 2 bankina me gjerësi 1.00m të asfaltuara
- Seksioni i afaltuar i rrugës është 9.50 m



Shtresat rrugore janë,

- Asfaltobeton 4cm
- Binder 6cm
- Konglomerate 8cm
- Shtrese Stabilizanti 20cm
- Shtrese Zhavorri 20cm

Projekti parashikon ndertimin e dy ura:

- 1- Ure me Hd=3x20m ne Pg. 0+745.00 - 0+805.70
- 2- Ure me Hd=5x29m ne Pg. 1+123.00 - 1+270.26

Gjithashu janë parashikuar ndertimi i shume tombinove (box&rrethore) dhe mure mbajtese, etj.


Mbeshtetur ne Vendimin e Keshillit Teknik Nr.17, date 05.05.2020 te Autoritetit Rrugor Shqiptar, Ne cilesine e Mbikqyresit te punimeve, janë rivleresuar edhe njehere te gjitha volumet e zerave te punimeve qe preken nga ky vendim dhe janë hartuar preventivi i punimeve brenda vleres se kontrates si dhe preventivi i punimeve qe ngelen jashte vleres se kontrates.

Per hartimin e preventivit te punimeve te Kontrates Baze eshte marre parasysh radha teknologjike si dhe ecuria e punimeve ne terren.





**J.V**  
**“47EK79 & ILIRIADA P.K.S.” sh.p.k**  
&  
**“GJEOKONSULT & CO” sh.p.k**



1. Ne preventivin e Kontrates baze jane perfshire punimet si me poshte:

- Nga km 0+000 deri në km 3+000 jane perfshire te gjitha punimet e parashikuara ne projekt.
- Nga km 3+000 deri në km 3+500 jane perfshire te gjitha punimet e parashikuara ne projekt pa shtresen e Asfaltobetoni.
- Nga km 3+500 deri në km 4+000 jane perfshire te gjitha punimet e parashikuara ne projekt pa shtresen e Biderit dhe Asfaltobetoni.
- Nga km 4+000 deri rreth km 5+350 jane perfshire te gjitha punimet e parashikuara ne projekt pa shtresat rrugore (shtrese zhavorri 20cm, shtrese stabilizanti 20cm, shtrese konglomerati 8cm, shtrese binderi 6cm dhe shtrese Asfaltobetoni 4cm).

2. Ne preventivin e Kontrates shtese jane perfshire te gjitha punimet e parashikuara ne projekt duke filluar rreth km 5+350 deri km 6+150 dhe shtresat rrugore si me poshte:

- Shtrese zhavorri lumi 20cm nga km 4+000 deri ne km 6+150
- Shtrese stabilizanti 20 cm nga km 4+000 deri ne km 6+150
- Shtrese konglomerati 8 cm nga km 4+000 deri ne km 6+150
- Shtrese binderi 6 cm nga km 3+500 deri ne km 6+150
- Shtrese asfaltobetoni 4 cm nga km 3+000 deri ne km 6+150


Ndarja e punimeve si me siper eshte bere per arsye se:

Kontraktori per nje periudhe te gjate deri ne daljen e Vendimit te Keshillit Teknik Nr.25, date 25/06/2019 te ARRSH-se ka punuar kryesisht ne segmentin e pare te projektit, pra nga Km 0+000 deri ne Km 3+700. Edhe pas VKT-se Nr.25, date 25/06/2019 te ARRSH-se punimet vazhduan deri ne Km 4+575 per sa i perket germimeve per trupin e rruges dhe deri ne km 4+125 per sa i perket germimeve per ndertimin e mureve mbajtes. Pjesa e punimeve shtese i perket segmentit nga km 4+575 deri ne km 6+150. Pra deri ne zbardhjen e Vendimit te Keshillit Teknik Nr.17, date 05.05.2020 te Autoritetit Rrugor Shqiptar, Kontraktori, ka punuar ne segmentin nga km 0+000 deri ne km 4+500 duke kryer te gjitha zerat e punimeve deri tek nenbaza sipas VKT-se Nr.25 date 25/06/2019. Prandaj ne preventivin e ripunuar te Kontrates baze jane perfshire shtresat asfaltike per kete segment ne qellim qe te mbrohen punimet e realizuara deri tani.





J.V  
"47EK79 & ILIRIADA P.K.S." sh.p.k  
&  
"GJEOKONSULT & CO" sh.p.k.



Gjithashtu kjo menyre e ndarjes se punimeve ndikon ndjeshem ne rritjen e rendimentit te punes sepse do te punohet ne te gjitha gjatesine e projektit dhe ne procese te ndryshme punimesh (germim, mbushje, vepra arti, shtresa rrugore etj.)

Ripunimi i preventivit te punimeve brenda vleres se kontrates baze eshte bere ne perputhje te plote me rekomandimet e Vendimit te Keshillit Teknik Nr.17, date 05.05.2020 te Autoritetit Rrugor Shqiptar, duke respektuar :

- Radhen teknologjike te kryerjes se punimeve.
- Ndikimi i punimeve te lotit 4 me fillimin e punimeve ne lotin 7 te ketij aksi rrugor
- Hartimi i nje preventivi te vecante per punimet qe dalin jashte vleres se kontrates baze
- Klasifikimi i materialit te dale nga germimi hap pas hapi

Të gjitha ndryshimet qe vijne si rezultat i klasifikimit te shtresave gjeologjike dhe zvogelimit te veprave te artit, jane paraqitur ne menyre te detajuar ne tabelen permbledhese te volumeve bashkengjitur ketij relacioni, shoqeruar dhe me vizatimit perkatese.

Si rezultat i te gjitha ndryshimeve te ardhura si rrjedhoje e riklasifikimit te shtresave gjeologjike sipas faktit dhe rivleresimit te gjeometrise se disa veprave te artit,

- Kostoja totale e punimeve do te jete **3.389.777.419,08 Lekë** me TVSH.
- Vlera e punimeve brenda kontrates eshte **2.831.535.003,09 Lekë** me TVSH,
- Vlera e punimeve shtese eshte **558.242.415,99 Lekë** me TVSH. (19.7%)

MBIKQYRESI I PUNIMEVE

Ing. Kujtim Çela

JV "47 EK 79 & ILIRIADA P.K.S." sh.p.k. & "GJEOKONSULT & CO" sh.p.k.

